

GRATË ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE COVID-19¹

Ndërhyrjet e domosdoshme për një reagim gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë Covid-19 dhe në situatë të tjera të krizave dhe emergjencave humanitare.

Mes personave me aftësi të kufizuara, gratë dhe vajzat përballen me pengesa sistematike për të garantuar barazinë dhe përfshirjen, duke qënë të padukshme në ligjet, politikat dhe praktikatat e aftësisë së kufizuar dhe ato të barazisë gjinore.

Gratë me aftësi të kufizuara kanë:

- tre herë më shumë gjasa të kenë nevoja të paplotësuara për kujdes shëndetësor;
- tre herë më shumë të ngjarë të jenë analfabete;
- dy herë më pak të ngjarë të punësohen;
- dy herë më pak të ngjarë të përdorin internetin;
- janë në rrezik të rritur të pësojnë dhunë seksuale krahasuar me ato pa aftësi të kufizuara.

KRIZA COVID-19 EKSPONON KËTO PABARAZI THEMELORE DHE PËRKEQËSON SITUATËN E GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

- Për to, pengesat e përditshme të tilla si aksesit fizik, pengesat në zbatimin e masave themelore të higjienës, përballueshmëria e kujdesit shëndetësor, kufizimet në sigurimin shëndetësor, ligjet diskriminuese dhe stigmatizimi, mund të jenë kërcënuese për jetën në mes të një pandemie.
- Gratë dhe vajzat mund të vuajnë dhunë në familje dhe dhunë seksuale për shkak të tensioneve të rritura në shtëpitë dhe institucione. Këtu përfshihen, ndër të tjera, gra me aftësi të kufizuara, gra që kujdesen për personat në ngarkim me aftësi të kufizuara, përfshirë fëmijët, të afërmit e moshuar, të cilët janë të mbyllur në shtëpitë e tyre si rezultat i mbylljes së shërbimeve shoqërore dhe institucioneve arsimore.
- Të mbijetuarat e dhunës mund të përballen me pengesa shtesë që nuk i lejojnë që të largohen nga situatat e dhunshme apo që të marrin urdhra mbrojtës ose shërbime thelbësore që mund të shpëtojnë jetë për shkak të faktorëve të tillë si bllokimi ose karantina.
- Ndikimi ekonomik i pandemisë mund të krijojë pengesa shtesë të cilat i lënë viktimat në një situatë të dhunshme familjare, duke krijuar rreziqe më të larta edhe të shfrytëzimit seksual.

MASA TË DIFERENCUARA GJATË PERIUdhËS SË PANDEMISË PËR GRATË DHE VAJZAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DHE PËR GRATË QË OFROJNË PËRKUJDESJE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Të shfrytëzohet partneriteti për të garantuar ndërhyrje të trefishtë:

- në nivel normativ, me akte ligjore, nënligjore, urdhëra, udhëzime, portokolle
- koordinim të aktorëve në të gjitha nivelet, qendror, rajonal, vendor dhe horizontalisht
- koordinim të aktiviteteve operacionale për të adresuar në mënyrë efektive sfidat me të cilat përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.

Të mblihdhen të dhëna dhe fakte/prova mbi situatën e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara:

- Duhet të merren masa për të promovuar mbledhjen, analizën, shpërndarjen dhe përdorimin e të dhënave të besueshme për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.
- Kur është e mundur, të bëhen analiza edhe mbi shkallën, nivelin e diferencuar të infeksionit [COVID-19] tek gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, informacion mbi pengesat me të cilat përballen gratë për të pasur qasje në programe mbështetëse apo ndihma humanitare, përfitimet nga mbrojtja sociale dhe normat e dhunës në familje dhe dhunës seksuale.

REAGIME/PËRGJIGJE PËRFSHIRËSE TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

Përgjigjet institucionale duhet të diferencojnë nevojat specifike të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, por edhe nevojat specifike që ato mund të kenë brenda secilit grup specifik të aftësisë së kufizuar. Kjo ka të bëjë me sigurimin që të gjithë vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara që kanë nevojë, të përfitojnë nga ndihma dhe mbështetja pa diskriminim

ZGJERIMI I QASJES DHE AKSESIT NË INFORMACION DHE KOMUNIKIM

Duhet të merren masa praktike për të siguruar që gratë me aftësi të kufizuara, përfshirë në zonat rurale, të kenë qasje në informacion të saktë dhe të arritshëm në lidhje me pandeminë, përfshirë informacionin për kujdesin shëndetësor, informacionin në lidhje me kufizimin e lëvizjes etj..

SIGURIMI I ANGAZHIMIT DHE KONSULTIMIT GJITHËPËRFSHIRËS ME PALËT E INTERESIT DHE PËRFITUESIT

- Gratë me aftësi të kufizuara duhet të angazhohen në të gjitha fazat e reagimit/masave dhe në të gjitha proceset e vendimmarrjes brenda institucionit(ve),organizatës(ve), ofruesit(ve) të shërbimeve.
- Të krijohen rrjete informale për gratë e prekura më shumë nga kriza, të tilla si gratë e institucionalizuara, gratë në moshë, gratë kujdestare, gratë me aftësi të kufizuara, etj. Mundësia për të bashkëvepruar me këto gra përmes ËhatsApp ose mediave sociale mund të jetë një shpëtim i vërtetë i jetës për to.
- Është vecanërisht thelbësore të rritet kapaciteti i këtyre grupeve lokale, joformale të grave me aftësi të kufizuara, si thelbësore në identifikimin dhe mbështetjen e grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara që janë viktime të dhunës në mjediset e komunitetit.

PËRMIRËSIMI I AKSESIT NË SHËRBIMET E SHËNDETIT DHE JETESËS

- Duhet avokim për të zgjeruar aksesin në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues, për të siguruar qasje, përfshirë në kujdesin shëndetësor para lindjes dhe pas lindjes për gratë me aftësi të kufizuara.
- Është thelbësore që në partneritet me OJQ-të e specializuara, t'u ofrohet informacion i saktë dhe i verifikuar grave shtatzëna me aftësi të kufizuara, partnerëve dhe familjeve të tyre, në mënyrë që ato të marrin vendime të përgjegjshme në lidhje me shëndetin e tyre dhe të fëmijëve të tyre për lindjen gjatë kësaj periudhe të koronavirusit, si dhe për të drejtën e tyre për të dhënë pëlqimin e tyre të lirë e të pandikuar, dhe të informuar për çdo procedurë kirurgjikale të lidhur me lindjen.
- Duhet advokuar për miratimin e masave për të siguruar kompensim të drejtëpërdrejtë të grave punëtore informale me aftësi të kufizuara, përfshirë personelin/gratë shtëpiake, dhe ato në sektorë të tjerë më të prekur nga pandemia, kështu që ato të mund të vazhdojnë të krijojnë të ardhura për jetesën.
- Është e rëndësishme për lëvizjen e aftësisë së kufizuar, të identifikojë në mënyrë specifike nënat e vetme me aftësi të kufizuara dhe me përgjegjësi prindërore në mënyrë që atyre t'u jepet përparësi në qasje në mbështetje ekonomike, ushqim, strehim dhe lloje të tjera të mbështetjes.
- Duhet të sigurohen shërbime gjithëpërfshirëse në përgjigje të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara, aty ku ekzistojnë duhet të qëndrojnë në dispozicion, ndërsa aty ku nuk ekzistojnë duhet të krijohen.
- Duhet të zhvillohen metoda të reja, gjithëpërfshirëse dhe të arritshme të ofrimit të shërbimeve në kontekstin aktual dhe njëkohësisht të rritet mbështetja për organizatat e specializuara të grave me aftësi të kufizuara për të qenë në gjendje të ofrojnë shërbime lokale dhe rajonale të mbështetjes.
- Duhet ushtruar advokaci për zbatimin e masave për të mbrojtur personat me aftësi të kufizuara dhe ata me më shumë dobësi që jetojnë në mjedise institucionale me rrezik të shtuar për të qenë të izoluar, apo që janë të izoluar apo të braktisur në ambientet e tyre të banimit për shkak të COVID-19, duke e bërë komunikimin përfshirës dhe mesazhet e shëndetit publik të arritshëm, përfshirë përmes interpretit të gjuhës së shenjave, përdorimit të tekstit në gjuhë të thjeshtë dhe formate të lehta për t'u lexuar.
- Duhet të zhvillohen politika të tilla të cilat na mundësojnë të njohim, zvogëlojmë dhe rishpërndajmë punën e papaguar brenda shtëpive për arsye të kujdesit shëndetësor dhe të kujdesit për personat me aftësi të kufizuara, punë që kryhet kryesisht nga gratë. Mund të inkurajohen organizatat dhe rrjetet e personave me aftësi të kufizuara të krijojnë linja telefonike falas duke ofruar mbështetje psikologjike për këto gra që shpesh janë nëna.

Ky dokument është përkthyer dhe përshtatur në gjuhën shqipe nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në kuadrin e projektit " COVID-19, Reagim Përfshirës për Aftësinë e Kufizuar", të mbështetur financiarisht nga Ballkan Trust for Democracy(BTD). Përbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e BTD.

Për të marrë informacione të mëtejshme në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe Covid-19, ju mund të lexoni materialet e publikuara në faqen tonë : <https://platforma-pak.al/te-drejtat-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-covid-19/>, ku keni dhe hapësirën e posaçme dedikuar për pyetjet tuaja.